



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGISË
DHE INDUSTRIË

Nr. 2024 / Prot.
5

Tiranë, më 22.12 /2015

Drejtuar: **Z. Petrit AHMETI**
Kryetar i Bordit të Komisionerëve të ERE

TIRANË

Lënda: Kthim përgjigje

I nderuar **Z. Ahmeti,**

Në përgjigje të shkresës Suaj nr. 638, datë, datë 28.10.2015, përsa i përket përcaktimit të tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike, në të cilat ngrini shqetësimet tuaja mbi këtë proces, nga ana e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë shprehim qëndrimin tonë si më poshtë:

Siç jeni në dijeni, gjatë këtyre dy viteve të fundit, Qeveria u përball me një situatë shumë të vështirë financiare në sektorin e energjisë elektrike, mbasi trashëgoi një sektor pothuaj ne prag të falimentimit me një situatë financiare pa likuiditete.

Pas zgjidhjes së konfliktit me CEZ, Qeveria u përball me sfida për stabilizimin e sektorit dhe kthimin e ligjshmërisë së pagesave duke hapur rrugë kështu investimeve në këtë sektor. Ne sajë të kësaj mbështetjeje, gjatë vitit 2015, rezultatet janë të ne reduktimin e humbjeve në më shumë se 7% dhe rritjen e arkëtimit me 10%, janë vërtet inkurajuese.

Paralelisht, Qeveria ndërmori një reforme legjislativë me hartimin e një kuadri të ri ligjor, e cila filloi me miratimin e ligjit për sektorin e energjisë elektrike dhe ligjin për sektorin e gazit natyror, në harmoni me paketën e trete legjislativë.

Gjithashtu sapo është miratuar në Kuvend ligji për eficienten e energjisë elektrike, ndërkohë që ka përfunduar hartimi i Planit Kombëtar të Energjisë të Rinovueshme i cili është në fazë miratimi. Në të njëjtën kohë po punohet gjithashtu për ndryshimet e nevojshme në ligjin e burimeve të rinovueshme të energjisë, për të përmbyllur kështu reformën legjislativë në këtë sektor.

Ligji i ri për sektorin e energjisë elektrike nr.43/2015, ka rritur në një shkallë më të lartë pavarësinë dhe forcimin e Rregullatorit dhe garanton hapjen e tregut, duke plotësuar kështu një nga kërkesat me kryesore të Direktivës 9072/2012. Ministria e Energjisë në këtë kuadër,